



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË MBROJTJES PËR VITIN 2023

Raporti i nënshkruar nga

Vlora Spanca,

Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, maj 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Mbrojtjes për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Mbrojtjes (MM), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Mbrojtjes, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të MM kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Çështje tjetër

- 1 Kontratat dhe pagesat në kategoritë, investime kapitale dhe mallra shërbime të cilat ishin të klasifikuara (niveli i kufizuar) nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, nuk janë pjesë e këtij raporti. Këto kontrata dhe pagesa auditohen ndaras dhe përgatitet një raport i veçantë i auditimit i cili do të ju komunikohet vetëm palëve përgjegjëse. Përderisa lëndët që e kanë nivelin e klasifikimit Sekret nuk janë audituar.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

UD Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, UD Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i Mbrojtjes është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Mbrojtjes.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Mbrojtjes është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Mbrojtjes në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Mbrojtjes me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Mbrojtjes.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Ministria ka shpenzuar rreth 87% të buxhetit final ose 177,943,593€ me një rënie të realizimit prej 8% krahasuar me vitin 2022. Fushat me probleme më të theksuara kanë të bëjnë me menaxhimin e proceseve si: vonesa në realizimin e projekteve dhe mangësi në menaxhimin e tyre. Mangësi tjera në menaxhimin e financave ishin edhe, mungesa e kompensimit të pagave sipas legjislacionit në fuqi, vonesa në pagesën e faturave dhe prezantimi jo i drejtë i pasurive (stoqeve).

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ky raport ka rezultuar me pesë (5) rekomandime, prej tyre dy (2) janë rekomandime të reja, një (1) rekomandim i përsëritur dhe dy (2) pjesërisht të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje është 36,757,706€, prej tyre janë shpenzuar 36,754,944 apo rreth 100%. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 4,884 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 4,710.

Çështja A1 - Kompensimi jo i plotë për punën jashtë orarit

Gjetja

Ligji për Pagat në Sektorin Publik, Neni 36 përcakton se zyrtarët publik dhe kategoritë e tjera të të punësuarve që paguhen nga buxheti i shtetit përfitojnë kompensim në vlerë monetare apo me pushim për punën me kujdestari, punën gjatë natës dhe jashtë orarit të punës, punën në fundjavë, punën në ditët e festave zyrtare. Por, edhe mund të kërkojnë nga punëdhënësi që në vend të kompensimit në pagë, kompensimi të bëhet me ditë pushimi.

Ndërsa Rregullorja (MM) Nr. 10/2019 Për Orarin e Punës në Forcën e Sigurisë së Kosovës përcakton se orari i plotë i punës zgjat dyzet (40) orë në javë ose tetë (8) orë në ditë, dhe pjesëtarët e FSK-së janë të obliguar t'i përmbahen këtij orari. Orari i punës për pjesëtarët e FSK-së është prej orës 08:00 deri në orën 16:00, prej të hënës deri të premten.

Ministria në mungesë të buxhetit e aplikon kompensimin me ditë pushimi. Gjatë analizimit të punës jashtë orarit të pjesëtarëve të FSK-së që e ushtrojnë këtë aktivitet kemi vërejtur se kompensimi me ditë pushimi në rastet kur mbahen kujdestari nuk është i rregulluar me ndonjë procedurë të shkruar mbi të drejtat që pjesëtarëve ju takojnë për pushim kur ata kujdestarojnë natën apo vikendeve. Nuk ka një procedurë të shkruar që specifikon se si kalkullohet puna jashtë orarit për tu kompensuar me ditë pushimi. Bazuar në të dhënat e analizuara shihet se FSK e aplikon dhënien e nga një dite pushim edhe në rastet kur ata kujdestarojnë me nga 24 orë me arsyetimin e mungesës së stafit.

Mungesa e një rregullimi të qartë për kalkulimin e kompensimit të punës jashtë orarit me ditë pushimi ishte shkaku i këtyre devijimeve. Arsye tjetër ishte edhe volumi i punëve dhe mungesa e personelit.

Ndikimi

Kompensimi jo i duhur qoftë financiar apo me ditë pushimi përveç që ndikën në motivim të pjesëtarëve gjithashtu paraqet rrezik që Ministria të ballafaqohet edhe me padi gjyqësore që do të kishin ndikim financiar duke shkaktuar edhe shpenzime tjera gjyqësore/përmbareme.

Rekomandimi A1

Ministri duhet të rishikojë rregulloret aktuale për orarin e punës duke i përshtatur me aktivitetin e saj dhe të sigurojë një rregullim të qartë në lidhje me kompensimin e punës jashtë orarit me ditë pushimi në mënyrë që të gjithë pjesëtarët të cilët shërbejnë jashtë orarit të kompensohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte 54,023,220€, prej tyre ishin shpenzuar 51,294,341€ apo 95%. Ato kanë të bëjnë kryesisht me karburant për vetura, furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare), furnizim me veshmbathje, municion dhe armë zjarri etj.

Çështja A2 - Vonesa në liferimin dhe mangësi në menaxhimin e barnave

Gjetja

Neni 2.1 i kontratës për “Furnizim me barna dhe material mjekësor për nevojat e FSK-së” me vlerë 67,754€ përcakton se afati kohor për liferim të barnave do të jetë 7 ditë nga data e lëshimit të Urdhër-blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

Rregullorja e MF - së Nr. 02/2013 – për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, në nenin 7 përcakton se të gjitha lëvizjet e pasurive jo financiare duhet të mbështeten në dokumente siç janë: fletë-pranimet, fletë-daljet dhe vetëm atëherë dokumentacioni do të konsiderohet i rregullt nëse dëshmohet me saktësi ndodhja e transaksionit dhe nëse përmban informata për shkakun e ndodhjes, datën dhe vendin e ndodhjes, llojin e pasurisë jo financiare, sasinë, vlerën dhe personat që kanë ekzekutuar transaksionin.

- Nga analiza e pagesës në vlerë prej 17,984€ e kontratës së lartcekur shihet që urdhër blerja ishte lëshuar me 09.11.2023, ndërsa barnat ishin pranuar me 07.12.2023 apo me 20 ditë vonesë, për të cilat vonesa nuk ishin aplikuar penalet siç parashihet me kontratë; dhe
- Menaxhimi i depos së barnave nuk është bërë përmes sistemit e-pasuria. Dalja e barnave tek kampet tjera apo pacientët nuk bëhet përmes e-pasurisë, por bëhet në formë fizike, dhe si rezultat stoku në depon e e-pasurisë mbetet i pandryshuar. Po ashtu, si rezultat i një planifikimi dhe menaxhimi jo të duhur të barnave (njësitë kërkuese kanë kërkuar barna pa pasur informata të sakta mbi stokun në depo) stoqet e barnave të skaduara ndër vite janë rritur dhe potencialisht do të ketë një kosto shtesë për asgjësimin e tyre.

Vonesa në furnizim ishte si rezultat i menaxhimit jo të mirë të procesit nga ana e menaxherit të kontratës të FSK-së.

Arsyeja pse nuk bëhet dalje e barnave nga e-pasuria nga moduli i spitalit ushtarak, është se depoja qendrore e FSK-së, ku pranohen të gjitha mallrat, nuk ka bërë dalje në modulën e e-pasurisë së spitalit ushtarak. Më tutje, njësitë kërkuese nuk bënë porosinë në bazë të kërkesave të njësitë tjera por bënë porosinë në bazë të një plani të shpërndarjes që nuk garanton se ekziston nevoja për të gjitha barnat e porositura.

Ndikimi

Vonesat në liferimin e barnave ndikojnë që pacientët e trajtuar nga mjeku, nuk do të kenë mundësi të marrin barnat në kohën kur ata kanë nevojë për to. Në anën tjetër planifikimi dhe menaxhimi jo i duhur me barna si rezultat i mungesës së informatave të sakta mbi gjendjen e stokut në depo, ndikon në mungesë të barnave për të cilat kanë nevojë apo skadim të afatit të atyre që rrinë në depo për një kohë të gjatë.

Rekomandimi A2 Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherëve të kontratave, se pranimi i barnave bëhet sipas afateve të dakorduara me qëllim që barnat të jenë në disponim me kohë, në të kundërtën duhet të aplikohen penalet për vonesa. Po ashtu, planifikimit dhe menaxhimit të stokut duhet ti paraprijë një vlerësim real i nevojave nga njësitë e kërkesave duke i shërbyer ata me informata të sakta mbi gjendjen e stokut në depo. Hyrje daljet e barnave nga depoja duhet të bëhen përmes e-pasurisë në mënyrë që të ketë pasqyrë të qartë gjatë gjithë kohës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 112,799,387€, prej tyre ishin shpenzuar 89,032,284€ apo 79%. Ato kanë të bëjnë me avance për investime, pajisje ushtarake, xhipa dhe kombibus, ndërtesa, pajisje të teknologjisë Informative dhe pajisje tjera.

Çështja B1 - Vonesë në realizimin e projekteve dhe mangësi në menaxhimin e tyre

Gjetja

Në dy projekte identifikuar vonesa në realizimin e punimeve përdorur në një projekt kishte pozicione që ishin paguar pozicione të pa përfunduara si:

- Projekti “Ndërtimi i objektit të akomodimit Kazerma Istog” në vlerë 659,661€, ishte paraparë të realizohej brenda 365 ditë kalendarike, sipas nenit 1.2 të kontratës dhe nenit 1.3 i cili thekson se “punimet do të fillojnë me marrjen e lejes nga menaxherët e kontratës dhe përfundoj në përputhje me planin dinamik (data e lejimit të punimeve ishte me 01.09.2022) nga ana e Autoritetit Kontraktues”.

Ky projekt është duke u vonuar në përfundimin e tij për së paku 3 muaj. Duke i marrë parasysh vonesat me arsye bazuar në dëshmitë e ofruara nga menaxheri i projekti, realizimi i projektit ishte planifikuar të finalizohet në dhjetor të vitit 2023, mirëpo gjatë ekzaminimit fizik kemi vërejtur që projekti nuk ishte kryer (ekzaminimi fizik mars 2024) dhe ende punimet vazhdonin;

- Projekti “Renovimi dhe ndërtimi i aneksit në Kazermën e FSK-së në Pomozotin” në vlerë prej 177,666€, e nënshkruar me dt. 21.06.2023 ishte paraparë të realizohej brenda 120 ditë pune, sipas nenit 1.2 të kontratës (fillimi i punimeve ishte me dt. 08.09.2023). Gjatë ekzaminimit fizik në mars 2024 kemi vërejtur se projekti nuk ishte përfunduar ende. Më tutje, ekzekutimi i pagesës për situacionin e tretë në vlerë 52,208€ pozicioni 14.3 Fabrikimi, sjellja dhe montimi i derës PVC, 150x240cm në vlerë 360€, nuk ishte vendosur edhe pse ishte bërë pagesa për këtë pozicion; dhe
- Te projekti “Ndërtimi i urës 4- Baba i Bokës - Gjakovë”, te pozicioni 1.7 Sinjalizimi horizontal dhe vertikal ishte paraparë (Furnizimi, transporti dhe vendosja e shenjave të komunikacionit duke përfshirë shtyllat metalike dhe betonimin e tyre). Gjatë ekzaminimit fizik vërejtëm se dy shtyllat metalike në vlerë 402€ edhe pse ishin paguar nuk ishin vendosur. Projekti kishte përfunduar dhe ishte pranuar teknikisht.

Tek projekti në Istog fillimisht vonesa kishte ndodhur për shkak, se objekti nga Komanda e Forcës Tokësore (G4KFT) nuk ishte liruar me kohë dhe Operatori kishte probleme në fazën e testimit të pajisjeve makinerike, ritrajtimit të izolimeve dhe demolimit dhe rivendosjes së pllakave të qeramikës.

Kurse tek projekti në Pomozotin sipas menaxherit të kontratës vonesat janë shkaktuar për shkak se punimet janë zhvilluar brenda objektit ku personeli i komandës së Gardës Kombëtare ka kryer angazhimet e veta ditore në objekt. Përdorur sa i përket vendosjes së derës prodhuesi nuk e ka sjell ende, po dera brenda dy dite do të vendoset për të cilën gjatë

kohës sa ishim në teren nuk na janë ofruar dëshmi se është vendosur.

Më tutje pozicionet për sinjalizimin e urës sipas menaxherit të kontratës nuk janë vendosur për shkak se OE ka kryer punë më shumë.

Ndikimi

Mos përgatitja e kushteve infrastrukturore me kohë nga ana e FSK-së, tregon se projektet kishin dobësi qysh në planifikim. Po ashtu, mos kryerja e punimeve sipas kushteve kontraktuale, menaxhimi jo i duhur i kontratës, shkakton vonesa të theksuara në realizim. Këto reflektojnë në mos arritjen e objektivave të parapara me buxhetin e vitit aktual, e që problemet e tilla mund të sjellin edhe vështirësi financiare për vitin e ardhshëm fiskal, duke kufizuar realizimin e projekteve të reja.

Rekomandimi B1

Ministri në koordinim me FSK-në duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprimet konkrete dhe me kohë për krijimin e parakushteve të infrastrukturës për të mundësuar përmbushjen e secilës kontratë të nënshkruar. Po ashtu, menaxherët e kontratave të bëjnë menaxhimin e duhur dhe pagesat të bëhen vetëm për punët e kryera sipas kushteve të parapara me kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 272,898,468€, pasurive jokapitale është 3,015,82€, si dhe e stoqeve 10,089,415€.

Çështja C1 - Mangësi në menaxhimin e pasurive përmes sistemit e-Pasuria

Gjetja Sipas Rregullores Financiare MF nr. 02/2013 - Për Menaxhimin e pasurisë jo financiare, në nenin 22 pikën 3 përcaktohet që të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t'i nënshtrohen normave të zhvlerësimit. Kurse neni 24 Raportimi i të njëjtës rregullore pika 3 përcakton se: Paraqitja e pasurisë jo financiare në Pasqyrat financiare vjetore do të prezantohet në bazë të vlerës kontabël neto.

Ne identifikuar se në sistemin e-Pasuria nuk ishte bërë zhvlerësimi i një pjese të pasurive nën 1,000€ (pasuria që nuk është zhvlerësuar ka vlerë prej 2,069,753€). Ministria nuk kishte informata se sa do të duhej të ishte vlera e zhvlerësimit të këtyre pasurive.

Po ashtu, kemi pasuri të cilat figurojnë në regjistrin e pasurive nën 1000€ me përshkrim të gabuar si në rastin, Laptop (25 copë) dhe kompjuter (100 copë) në vlerë totale 70,000€ ishin regjistruar si Overboot Lightweight, CBRN, AFS dhe kit, C420 Plus Paper W/Battery. Më tutje Radio portative VHF 20 copë dhe 50 copë tjera në vlerë 50,754€, në sistem figuronin si material shpenzues, Letër A4/160gr/M dhe Flamur i RMC me thekë 100x80.

Gjatë vizitës që i kemi bërë depove qendrore sa i përket ndryshimit të emërimit të aseteve, kemi vërejtur se depoistët e bëjnë pranimin dhe regjistrimin e mallit sipas emërimit të aseteve dhe në mënyrë të saktë, mirëpo ndryshon emërtimi tek raporti sipas vlerës, por nuk ndryshojnë vlerat.

Shkaqet për gjenerimin e raporteve me përshkrime të gabuara përkundër regjistrimit të duhur nga depoistët nuk ishin hulumtuar dhe analizuar nga ana e stafit të Ministrisë për identifikimin e problemit. Po ashtu, ne nuk kemi vërejtur edhe ndonjë kërkesë për ndihmë konkrete nga mirëmbajtësi i sistemit të e-pasurisë për zgjidhjen e këtij problemi.

Ndikimi Mos zhvlerësimi i pasurive ndikon që informatat e prezantuara në PFV, të jenë jo të plota dhe jo të sakta dhe si rrjedhojë kemi mbivlerësim të pasurive neto. Në anën tjetër mosfunksionimi siç duhet i sistemit e-pasuria, vështirëson menaxhimin dhe kontrollin e pasurive në dispozicion, krijon konfuzion në lidhje me llojin dhe klasifikimin e pasurive dhe rrit rrezikun e humbjes dhe keqpërdorimit të pasurive.

Rekomandimi C1 Ministri duhet të siguroj përmes menaxherit të financave që pasuritë nën 1000€ janë prezantuar në mënyrë të plotë dhe të saktë në PFV. Po ashtu, Ministria duhet të ndërtojë një bashkëpunim efektiv me mirëmbajtësin e sistemit e-pasuria për eliminimin e gabimeve gjatë tërë vitit në mënyrë që sistemi e-pasuria të gjenerojë me saktësi pasurinë e regjistruar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.5 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2023, ishte 14,385,507€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2024. Vlera e detyrimeve për shpenzime kapitale prej 12,230,000€ kishte ndodhur si rezultat i kthimit të pagesave nga Banka Qendrore e Kosovës, pasi që banka ndërmjetësuese nuk e kishte kryer transaksionin me kohë.

Çështja C2 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për MFPP, çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuar dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendrike pas pranimit të faturës. Ne identifikuam se:

Tri fatura në vlerë prej 93,346€ € ishin paguar me vonesë duke filluar nga 10-25 ditë, dhe dy fatura në vlerë prej 1,469€ megjithëse ishin pranuar në fillim të nëntorit 2023, deri në mars 2024 (sa ishim në auditim), nuk ishin paguar.

Shkaqet për vonesa janë të ndryshme, si mos përcjellja me kohë e faturave në zyrë të financave, mbyllja e afatit të pagesave, dhe vonesa në regjistrimin e Operatorëve Ekonomik në SIMFK.

Ndikimi Vonesat në realizimin e pagesave në afatin e përcaktuar, mund ta bëjnë Ministrinë subjekt të padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë përmbarimore. Njëkohësisht, kjo shpreh edhe funksionin jo efikas të kontrollit në ministri rreth procesit të pagesave.

Rekomandimi C2 Ministri duhet të sigurojë se të gjitha obligimet paguhen brenda afatit ligjor, siç është përcaktuar me ligj, në mënyrë që të shmangen kostot shtesë si pasojë e pagesave me procedura përmbarimore apo gjyqësore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁷	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	123,227,261	204,718,312	177,943,593	137,592,675	91,615,107
Grante Qeveritare – Buxheti	123,227,261	204,718,312	177,943,593	137,592,665	91,267,418
Donacionet e jashtme	0	0	0	10	347,689

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 81,491,051€. Ndryshimet buxhetore kanë ardhur si rezultat i rishikimit buxhetor dhe vendimeve të qeverisë.

Në vitin 2023 Ministria ka shpenzuar 87% të buxhetit final ose 177,943,593€ me një përqindje më të ulët të realizimit se në vitin 2022. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	123,227,261	204,718,312	177,943,593	137,592,675	91,615,107
Pagat dhe mëditjet	32,103,815	36,757,706	36,754,944	29,121,779	25,930,519
Mallrat dhe shërbimet	42,046,600	54,023,220	51,294,124	13,788,259	8,196,552
Komunalitë	1,138,000	1,138,000	862,240	782,841	758,968
Investimet Kapitale	47,938,846	112,799,387	89,032,284	93,899,796	56,729,068

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 4,653,891€, me vendime të Qeverisë. Realizimi i buxhetit final ishte afër 100%. Rritja e buxhetit ishte si rezultat i mungesës së mjeteve për pagesën e pagave për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor për 629 rekrutët e ri. Po ashtu më hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 Për Pagat në Sektorin Publik nga muaji shkurt 2023, janë rritur pagat e nënoficerëve dhe pagat e eksperteve të TI-së në shumë të konsiderueshme. Të gjitha këto transaksione kanë pas implikim financiar shtesë.

- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 11,976,620€. Rritje e buxhetit në mallra dhe shërbime vjen nga vendimet e Qeverisë për pagesën e obligimeve doganore dhe blerjeve ushtarake. Realizimi i buxhetit final ishte 95%. Krahasuar me vitin paraprak kishte rritje të shpenzimeve në këtë kategori për 37,506,082€, e që rritja e shpenzimeve është e ndërlidhur me lejimin e avanceve (për blerje ushtarake) deri në njëqind për qind (100%), që kanë të bëjnë me aktivitete që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë e Republikës së Kosovës.
- Buxheti final dhe fillestar për komunalitet ishte 1,138,000€. Realizimi i buxhetit final ishte 76%; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 64,860,541€. Rritja e buxhetit në investime kapitale vjen nga vendimet e Qeverisë për mbulimin e obligimeve kontraktuale, pagesën e obligimeve doganore dhe për blerje ushtarake. Realizimi ishte 79%, për shkak që aktiviteti i prokurimit (aktivitet i klasifikuar) për kamion ka dështuar, për të cilin kanë qenë të planifikuara rreth 9,300,000€ si dhe kthimi i një pagese nga BQK si rezultat i mos kryerjes së transaksionit me kohë nga banka ndërmjetësuese, në vlerë prej 12,300,000€. Krahasuar me vitin paraprak ka zvogëlim të shpenzimeve nga kjo kategori për 4,867,512€, e që kjo ndërlidhet kryesisht nga lejimi i buxhetit në mallra dhe shërbime për blerje ushtarake.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Ministria në vitin 2023, nuk ka realizuar të hyra, pasi që nuk ka pasur ndonjë aktivitet por që kishte kthime të buxhetit në vlerë 170,332€ dhe këto janë regjistruar si të hyra të vitit të kaluar. Arsyeja e kthimit të këtij buxheti ishte rezultat i ndërprerjes të shkollimit të disa kadetëve etj.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	116,484	116,484	170,332	165,919	6,175
Të hyrat jo tatimore	116,484	116,484			
Të hyrat tjera	0	0	170,332	165,919	6,175

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2022 ka rezultuar me shtatë (7) rekomandime. MM kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Gjithashtu, ka dorëzuar Raportin e progresit mbi zbatimin e rekomandimeve me 30 shtator dhe 15 mars.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, ne kemi identifikuar se katër (4) rekomandime ishin zbatuar, një (1) rekomandim i përsëritur, dhe dy (2) ishin pjesërisht të zbatuara siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Duhet theksuar se çështja e avanceve të hapura nga mallrat dhe shërbimet që e kishte ndikuar opinionin e vitit të kaluar është adresuar nga ana e Ministrisë dhe është rregulluar me Ligjin e Buxhetit për vitin 2023 në pikën 5 të nenit 13 "Pagesat e Paradhënies", ku lejohen avancet për projekte dhe aktivitete deri 100% nga ndarjet buxhetore të vitit aktual që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe sigurinë e Republikës së Kosovës.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministri duhet të siguroj se janë vendosur kontrole efektive me qëllim që të parandalohet mbyllja e avanseve para se të jenë pranuar shërbimet e trajnimit sipas marrëveshjes. Po ashtu, duhet të sigurohet një monitorim efektiv rreth pranimit të trajnimeve për të cilat ishte dhënë avansi.	Mbyllja e avnceve nga mallrat dhe shërbimet, është rregulluar me Ligjin e Buxhetit për vitn 2023 në pikën 5 të nenit 13 "Pagesat e Paradhënies", ku lejohen avancet për projekte dhe aktivitete deri 100% nga ndarjet buxhetore e vitit aktual që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe sigurinë e Republikës së Kosovës.	I zbatuar
2.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të siguroj përmes menaxherit të prokurimit dhe njërive kërkuese që para inicimit të aktiviteteve të prokurimit të bëhet hulumtimi i tregut dhe të bëhet planifikimi adekuat i secilit aktivitet të prokurimit. Aplikimi i procedurës së negociuar pa publikim, përdoret për dhënie e çdo lloji të kontratës, nëse rrethanat e arsyetojnë përdorimin e kësaj procedure duke qenë sa më transparent dhe duke eliminuar kufizimin e konkurrencës. Po ashtu, duhet siguruar se aplikohen penalet për shkak të vonesave të theksuara në liferimin e mallit.	Për vitin 2023 nuk kemi identifikuar raste të tilla.	I zbatuar
3.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri në koordinim me FSK-në duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprimet konkrete dhe me kohë për krijimin e parakushteve të infrastrukturës për të mundësuar përmbushjen e secilës kontratë të nënshkruar sipas kushteve të parapara.	Gjatë vitit 2023 kemi identifikuar raste të tilla, tek kategoria e investimeve kapitale.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Investimet kapitale	Ministri përmes menaxherit të prokurimit dhe njërive kërkuese duhet të siguroj se kriteret në dosje të tenderit të jenë specifike, të qarta, të matshme dhe dëshmitë e kërkuara të jenë të ndërlidhura me ato kriteret.	Gjatë auditimit për vitin 2023 nuk kemi identifikuar raste të tilla.	I zbatuar
5.	Pasuritë	Ministri duhet të siguroj përmes zyrtarit të e-pasurisë korrigjimin e gabimeve në mënyrë që pasuritë të janë prezantuar drejtë në PFV. Po ashtu çdo pasuri e fituar-transferuar nga OB tjera të ketë dokumente burimore.	Janë bërë disa korrigjime, mirëpo prapë kemi identifikuar probleme tjera në sistemin e-pasuria.	Pjesërisht i zbatuar
6.	Obligimet e papaguara	Ministri duhet të sigurojë se të gjitha obligimet paguhen brenda afatit ligjor dhe se menaxheret e kontratave duhet ta kenë parasysh afatin e kontratave, në mënyrë që të shmangen kostot shtesë si pasojë e pagesave me procedura përmbartimore apo	Vonesë në pagesën e faturave kishte edhe në vitin 2023, mirëpo vlen të theksohet se këtë vit edhe pse kishte vonesa nuk	Pjesërisht i zbatuar

		gjqësore. Po ashtu, duhet shtuar kujdesin gjatë pranimit të faturave për të shmangur devijimet e mundshme në mes faturës dhe marrëveshjes.	kishte pagesa shtesë të përbarimit.	
7.	Detyrimet Kontingjente	Ministri duhet të siguroj një koordinim në mes zyrës ligjore dhe ZKF në mënyrë që detyrimet kontingjente azhurnohen dhe prezantohen në përputhje me kërkesat të rregullores për Raportim Vjetor Financiar.	Për vitin 2023 nuk kemi identifikuar mangësi të tilla.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit



Ariana Berisha Rexhëbeqaj, Udhëheqëse e ekipit



Gazmend Namani, Anëtar i ekipit



Adelina Selmani, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

Leter konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DOKUMENTI I KONTROLLIMIT Dokumenti i Kontrollimit Dokument of Control			
Nr. Dokumenti i Kontrollimit No. of Control Document No. of Control Document			
03	47	507	2

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E MBROJTJES- MINISTRY OF DEFENSE			
Nr. Protokollit No. of Protocol No. of Protocol			
1404		2	
Data Date Date			
13.05.24		24	

Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Mbrojtjes
 Ministarstvo Obrane / Ministry of Defense

DATE/A:	13.05.2024
REFERENC-E:	1/320/2024
PER/ZATO:	Zyrën e Kombëtare të Auditimit
CC:	Gafurr Dugolli, U.d Sekretar i Përgjithshëm në MM
PERMES/PREKO/THROUGH:	Ejup Maqedonci, Ministër i Ministrisë së Mbrojtjes
NGA/OD/FROM:	Konfirmimi i pranimit të draft-raportit të auditimit 2023!
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	

Të nderuar/a,

Bashkangjitur kësaj shkrese ju dërgojmë letër konfirmimin për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023, dhe konfirmojmë se kemi pranuar draft-raportin e ZKA për auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Mbrojtjes.

Me respekt!

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **Ministrisë së Mbrojtjes**, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejme "Raport");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit në përjashtim .
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Ejup Maqedonci, Ministër i Ministrisë së Mbrojtjes,
 Data: 13.Maj 2024.

Me respekt!

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁹ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁹, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Orari i punës për pjesëtarët e FSK-së është prej orës 08:00 deri në orën 16:00, prej të hënës deri të premten.
- ⁶ Pasuri që janë nga vitit 2007 e deri më tani.
- ⁷ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁸ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁹ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.